

## DRITËHIJE

Zezonë në dukje e padepërtueshme, frikë, plot hije të çoroditura, një rrugëtim i rrezikshëm i mbushur me gracka, të cilave u duhen deshifruar simbolet dhe fytyrat e fshehura që të ecet përpara në rrugën e të kuptuarit dhe të dritës. Dhe më vonë, pas një pune të gjatë dhe plot durim, duke gërmuar thellë në kërkim të së vërtetës, misteret e realitetit zbulohen papritur, me prekje të vogla të njëpasnjëshme; spiralja e ankthit ngecet në vend dhe drita e dijes, duke grisur errësirën e padepërtueshme, tregon rrugën dhe pastaj ndriçon punën që duhet bërë.

Vendime gjykatash speciale që eliminojnë pothuajse gjithë elitën intelektuale të kombit. Qeli të tmerrshme burgjesh, qindra vuajtës që vdesin nga torturat çnjerëzore. Kurthe, intriga, dëshmi të rreme e akuza false. Jetë njerëzish të pafajshëm që shuhën përfundimisht ose tjetërsohen në mënyrë të dhimbshme vetëm sepse kërkonin dritë. Viktima të sistemit të zi stalinist. Por fati i tyre tragjik nuk përfundoi me kaq. Hijet zgjaten dhe kërkojnë të përpijnë gjithçka. Edhe të afërmit,

edhe familjarët, me një kalvar të mundimshëm vuajtjesh nëpër kampet e internimit. Në emër të diktaturës së proletariatit e luftës së klasave: dhunë fizike e psikologjike duke i kaluar të gjitha caqet njerëzore.

Imazhe gri të muzeut Kombëtar të Përgjimeve: “Shtëpia me Gjethe”. Sektorë me pamje, filmime, dokumente dhe fotografi, me dritëhije ku e zeza shërben si shenjim i misterit dhe i sekreteve që bart godina. Histori agjentësh, bashkëpunëtorësh, emra të fshehur e të zbuluar, viktima që kthehen në bashkëpunëtorë dhe bashkëpunëtorë që kthehen në viktima, përgjues e të përgjuar.

E zeza dhe e bardha të mpleksura me njëra tjetrën. Mister dhe sekrete. Gjethe që mbulojnë dritën e diellit dhe krijojnë hije. Rreze drite që arrijnë të depërtojnë. Hijë që zgjaten e përpiqen të mbulojnë sa munden.

Pse u ndërtua ky muze? Pse ndërtesën e Sigurimit? Po Spaçi? Po të përndjekurit e të persekutuarit? Po hidhni poshtë punën e Sigurimit. Pse u nderuan eshtrat e Mid’hat Frashërit, të Faik Konicës? Ahmet Zogu? Enver Hoxha...

Ngjarje, personazhe e figura historike kombëtare të veshura me dritëhije sepse historinë e shkruajnë fitimtarët dhe e politizojnë në funksion të interesave.

Vende, ngjarje e figura të fetishizuara e glorifikuara, të mohuara, të nxira, të anatemuara të cilat presin vlerësim të qetë e objektiv, mbështetur në dokumente e në logjikën e historisë, larg sajësive, thashethemeve e manipulimeve.

Qëndrime të skajshme, euforike apo të egërta që ndajnë e që nuk lejojnë mendimin e gjykimin objektiv, real që çmon së pari çdo gjë pozitive në ndodhitë, ngjarjet, jetën e veprimtarinë e figurave, por nuk i injoron e anashkalon dhe problemet apo gabimet, të cilat të analizuara me qetësi, kthehen në përfundime e në mësim, për shoqërinë, për të ardhmen.

Dritë që buron nga kujtesa, nga dokumentimi i krimeve të diktaturës dhe totalitarizmit komunist, nga kujtimi i atyre që mundën të mbijetojnë e që davarit zezonën. Këtë mëton të tregojë *Dritëhije*.

**Etleva Demollari**

*Drejtoreshë e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve  
“Shtëpia me Gjethe”*